



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AVOKATI I POPULLIT
Seksioni i Përgjithshëm



Adresa: Bulevardi: "Zhan D'Ark" Nr.2
Tiranë, Shqipëri

Tel/Fax: +355 4 2380 300/315
E-mail: ap@avokatipopullit.gov.al
www.avokatipopullit.gov.al

Nr. Prot.
Nr. Dok. 201402136/2

Tiranë ___/___/2014

Lënda: *Rekomandojmë rillogaritjen e masës së pensionit të pleqërisë të shtetasit D.P.*

Drejtuar: **Z. Arsim RAMA**
Drejtorit të Drejtorisë Rajonale
të Sigurimeve Shoqërore

TIRANË

Pranë Institucionit të Avokatit të Popullit ka paraqitur ankesë shtetasi D.P, në përmbajtjen e së cilës ankohet për masën e ulët të pensionit të pleqërisë dhe kërkon rillogaritjen e pensionit.

Sipas shpjegimeve të tij, ankuesi ka dalë në pension të parakohshëm më datë 16.01.1995 dhe pension pleqërie më datë 16.09. 2004. Pavarësisht se ka përfituar të gjitha shtesat të bëra në vite sipas vendimeve të Këshillit të Ministrave, masa e pensionit të tij, ka arritur në shumën e 15818 lekë në muaj.

Ai shprehet se nuk ka përfituar nga neni 3 i Ligjit nr.9588 datë 25.07.2006 "Për rillogaritjen e pensioneve", pavarësisht se i ka patur pagat e dokumentuara e të paraqitura në kohën e caktimit të pensionit. Gjithashtu nuk ka përfituar nga VKM nr.440 datë 21.06.2006 "Për përcaktimin e koeficienëve të indeksimit të bazës së vlerësimit vjetor, individual. Për llogaritjen fillestare të pensioneve".

Ankuesi pretendon se bazuar në vjetërsinë e përgjithshme të punës së tij prej 32 vitesh, nga të cilat 15 vite i ka punë në minierë, kategoria e VI, si edhe nga mospërfitimet e sipërcituara, masa e pensionit të tij duhet të ishte më e lartë dhe ka kërkuar ndërmjetësimin tonë institucional për të mundësuar rillogaritjen e pensionit të tij të pleqërisë.

Libreza e Pensionit është me nr.9294/I.

Sa më lart, në mbështetje të pikës 3, të nenit 63 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë ku thuhet se: “Avokati i Popullit ka të drejtë të bëjë rekomandime dhe të propozojë masa kur vëren shkelje të të drejtave dhe lirive të njeriut nga administrata publike”, si dhe në bazë të nenit 21/b të Ligjit Nr.8454 datë 04.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”, i ndryshuar, ku thuhet se : “Paraqet rekomandime për vënien në vend të së drejtës së shkelur tek organi administrativ, që, sipas tij ka shkaktuar shkelje të të drejtave dhe lirive”,

REKOMANDOJMË:

Rillogaritjen e masës së pensionit të pleqërisë të shtetasit D.P.

Në përputhje me nenin 22 të Ligjit “Për Avokatin e Popullit”, ku thuhet shprehimisht se: “Organet të cilave Avokati i Popullit u ka drejtuar një rekomandim, duhet ta shqyrtojnë rekomandimin dhe të kthejnë përgjigje brenda 30 ditësh nga data e dërgimit të rekomandimit”,

Lutemi ta shqyrtoni dhe të na vini në dijeni për qëndrimin tuaj ndaj këtij rekomandimi.

Duke besuar në mirëkuptimin dhe bashkëpunimin Tuaj,

K O M I S I O N E R I

Ermir KAPEDANI